



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 5139 prot.

Tiranë, më 17/11 /2020

URDHËR

Nr. 633, datë 17.11.2020

PËR

NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si edhe Vendimit të Komitetit Teknik nr. 4156/datë 16.11.20

URDHËROJ:

1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë.
2. Pika 4 e Urdhrit nr. 351 datë 29.05.2020 "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19" të ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid19", i ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI

Ogerta Manastirliu